



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 198/5 prot.

Tiranë, më 24.5.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 524, datë 8.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elfrida Bregova
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.5.2022, është njoftuar vendimi nr. 524, datë 8.4.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Elfrida Bregova, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 524, datë 8.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, prej vitit 2006 e në vijim, ushtron detyrën e prokurores, aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe në

zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Elfrida Bregova ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Elfrida Bregova*”, ka referuar për subjektin, se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, me nr. *** prot., datë **.11.2017¹, sugjeron që në tërësinë e vlerësimit të figurës të mbahet në konsideratë fakti se, më datë **.1.2017, subjektit të rivlerësimit i është revokuar viza e hyrjes në SHBA.

2.3 Në raport, pasi pasqyrohet fakti se është përpiluar në mungesë të informacionit nga ana e SHISH-it, në përfundim, referohet për subjektin e rivlerësimit: “*Përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës*”.

2.4 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Bregova, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “*Vetting*”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] 32. ... *nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting” pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. 32.1. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e*

¹ Deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) nr. ***, datë **.5.2021.

pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. 32.2. Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve përkatëse. 32.3. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]².

4. Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e përgatitur nga DSIK-ja dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] 33.5 ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimeve të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]³.

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

6. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

² Për më tepër referohuni në f. 39, të vendimit të Komisionit.

³ Për më tepër referohuni në f. 41, të vendimit.

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 524/2022, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenueshëm, së paku, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, pasi përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë, e për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 524/2022, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në përmbajtjen e akteve të fashikullit, për subjektin e rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, referuar përcaktimeve të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

13. Në këto kushte, në vlerësim dhe të faktit se raporti i DSIK-së është hartuar pa u administruar informacioni i SHISH-it, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionit Publik ndaj vendimit nr. 524/2022, të Komisionit, ushtrohet për këto dy kriteret rivlerësimi.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Për kontrollin e pasurisë

14. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar çështje që lidhen me saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

16. Interesat private dhe pasurore, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “*Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës*”, dorëzuar në ILDKPKI, më datë **.11.2006, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2006 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “*Vetting*” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, rezulton se:

17. Pasuria Apartament me sipërfaqe 87.3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73.5 m², me nr. pasurie *, z.k. ***, ndodhur në rrugën “*** **”, Tiranë**

17.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pasuria me nr. *** z. k. ***. Lloji i pasurisë Apartament me sipërfaqe 87.3 m² dhe 73.5 m² verandë. Adresa “*** **”, ish-*** ***, Tiranë. Kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2012. Vlera 104.000 euro, pjesa takuese 50%.*

17.2 Burimi i krijimit deklarohet si vijon: (i) Depozita bankare në *** Bank, në emër të ***. ***, datë **.7.2012, në vlerën 3.000.000 lekë, ku janë depozituar të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit; (ii) Huaja e marrë nga shtetasi ***.***, me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 50,000 euro; (iii) Huaja e marrë nga shtetasi ***.***, me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 3.000,000 lekë⁴; (iv) Huaja e marrë nga shtetasi ***.***, me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 1,200,000 lekë.

17.3 Në DV- 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi, me nr. *** nr. *** kadastral, sip. 87.3 m² dhe 73.5 m² verandë, në rrugën “*** **”, Tiranë. Burimi i krijimit: (i) Tërheqje depozite bankare në *** Bank, në emër të ***.***, datë **.7.2012, në vlerën 3.000.000 lekë; (ii) Huamarrje në vlerën 50,000 euro; (iii) Huamarrje në vlerën 3.000,000 lekë; (iv) Huamarrje në vlerën 1,200,000 lekë. Vlera 104.000 euro, pjesa takuese 50%.*

18. Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka depozituar së bashku me Deklaratën “*Vetting*”, aktet si vijon:

18.1 Kontratë sipërmarrje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.7.2012, me anë të së cilës personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti, z. ***.***, ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k., apartamentin me nr. ***, me sip. 99.2 m², nga të cilat sipërfaqe banimi 87.3 m², sipërfaqe e përbashkët 11.9 m² dhe 73.5 m² verandë.

18.1.1 Në nenin 13 të kësaj kontrate përcaktohet çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 104.000 euro⁵ dhe mënyra e shlyerjes, sipas së cilës: (i) shuma 97.000 euro do të paguhet me

⁴ Subjekti ka deklaruar, gjithashtu, se kjo hua është shlyer dhe si burim kanë shërbyer: “... të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit, si dhe vlera prej 10,000 euro, dhuruar nga nëna ime, *** ***, deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.9.2012”.

⁵ Sipas aneksit të kontratës, çmimi për metër katror i sipërfaqes së brendshme të apartamentit është 765 euro, ndërsa për verandën është 382.5 euro.

lidhjen e kontratës; dhe (ii) shuma 7.000 euro do të paguhet me dorëzimin e hipotekës. Porositësi duhet të kryejë pagesën në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi.

18.2 Kontratë shitblerje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë **.7.2012, ku tashmë përcaktohet si objekt i kontratës, apartamenti i identifikuar me nr. **, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sipërfaqe banimi 87.3 m² dhe 73.5 m² verandë. Çmimi i shitjes 104.000 euro. Në nenin 2.2 të kësaj kontrate përcaktohet se çmimi i shitjes është paguar totalisht nga blerësi, përpara lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka pretendime për të.

18.3 Në lidhje me mënyrën e pagesës për pasurinë *apartament*, përveç dy kontratave të përshkruara si më sipër, subjekti i ka bashkëlidhur Deklaratës “Vetting” edhe dy shkresa të shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe dy mandate arkëtimi ku vërehet se:

18.3.1 Në shkresën nr. *** prot., datë **.7.2012, përkundër parashikimeve të kontratës së porosisë, përcaktohen tri pagesa, ku palët bien dakord që, me lidhjen e kontratës së porosisë në datë **.7.2012, do të shlyhen dy pagesa, njëra në bankë, në shumën 73.000 euro, dhe tjetra do të paguhet *cash*, në shumën 24.000 euro. Ndërsa me dorëzimin e hipotekës do të paguhet në bankë shuma e mbetur prej 7.000 euro.

18.3.2 Në shkresën tjetër të kësaj shoqërie, me të njëjtat ekstremitete, përcaktohen dy pagesa, të njëjta si në parashikimet e kontratës së porosisë, ku palët kanë rënë dakord që, me lidhjen e kontratës në datën **.7.2012, do të paguhet në bankë shuma 97.000 euro dhe pagesa tjetra do të paguhet në bankë, në shumën 7.000 euro, me dorëzimin e hipotekës.

18.3.3 Ndërkohë, në mandat-arkëtimin e shoqërisë “****” sh.p.k., me nr. **, datë **.7.2012, rezulton se z. ***.*** ka paguar *cash* në arkën e shoqërisë shumën 97.000 euro, me destinacion: “*Pagesë për Ap. ****”. Me shkresë të thjeshtë, me emërtimin “Arkëtim” (fletë format A4, me shkrim dore), datë **.7.2012, është paguar shuma 7.000 euro, me përshkrimin: “*Z. ***.***, apartament ***, depozitoi sot në datën **.7.2012, shumën 7.000 euro, për këstin e fundit të ZVRPP. Nesër në datën **.7.2012, jemi gati për kontratën e shitjes*”, nënshkruar nga shtetasja ***.*** (me vulën e *** ** Albania).

19. Në dosjen e ILDKPKI-së janë administruar dy shkresa nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, respektivisht me nr. *** prot., datë **.5.2017, dhe nr. *** prot., datë **.5.2017. Me anë të këtyre shkresave, ky institucion, ndër të tjera, ka informuar ILDKPKI-në, se: (i) për shtetasin ***.*** ka raportime të kontratave noteriale sipas së cilave, në datën **.7.2012, ka blerë një apartament për shumën 104.000 euro; (ii) ka raportime të transaksioneve bankare, ku është identifikuar edhe transaksioni i datës **.12.2012, i kryer në ***, në shumën 21.493 euro, me përshkrimin: “*derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. ****”; si dhe (iii) rezultojnë 7 raportime nga subjekti “****” sh.p.k., me NIPT: ***, gjatë muajve nëntor-dhjetor 2012, për shumën totale rreth 89.000 euro, si pagesa kësti nga shtetasi ***.*** ndaj shoqërisë, për blerje apartamenti.

19.1 Duke marrë në konsideratë sa më sipër, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka hartuar “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova⁶”, ku ndër të tjera, ka konstatuar:

⁶ Raportit të ILDKPKI-së nr. *** prot., datë **.8.2018, f. 21.

- Pagesat e kryera ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., sipas DPPP-së, për blerje apartamenti, të kryera në periudhën nëntor-dhjetor 2012, si dhe derdhja në *** për likuidim kësti apartamenti, në shumën 21.493 euro, nuk përkojnë me deklarin e kryer nga subjekti, rrjedhimisht, subjekti ka deklarim të rremë lidhur me vlerën e paguar për apartamentin në rrugën “**** ****” dhe/ose ka fshehje të pagesave gjatë periudhës së konfirmuar dhe qëllimit të tyre gjithashtu.

20. Komisioni rezulton se ka hetuar lidhur me pagesat e kryera nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, për blerjen e apartamentit në rrugën “**** ****”, Tiranë, duke kërkuar informacion pranë shoqërisë “****” sh.p.k., dhe bankave të nivelit të dytë, hetim nga i cili kanë rezultuar këto fakte:

20.1 Shoqëria “****” sh.p.k.⁷, me shkresën e datës **.6.2021, ka informuar Komisionin se klienti ***.*** ka prenotuar pranë kësaj shoqërie, sipas kontratës së sipërmarrjes, apartamentin nr. ****⁸, dhe se pagesa për këtë apartament është kryer me këste në llogarinë bankare të shoqërisë dhe se asnjë këst nuk është paguar cash në arkën e shoqërisë. Bashkëlidhur kësaj shkrese, ndër të tjera, shoqëria ka depozituar: (i) Kartelën e klientit ***.***, ku pasqyrohen nëntë pagesa të kryera në *** Bank⁹ dhe një pagesë e kryer në **, gjatë periudhës **.7.2012 - **.12.2012; dhe (ii) Deklaratën “Për marrjen në dorëzim të njësisë nr. ****”, nr. *** prot., datë **.7.2012, në të cilën deklarohet se është kryer pagesa në shumën 97.000 euro, nënshkruar nga deklaruesi, z. ***.***, dhe përfaqësues të shoqërisë “****” sh.p.k.

20.2 Në vijim, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2021, i është drejtuar përsëri për sqarim shoqërisë “****” sh.p.k., pasi ka evidentuar mospërputhje në përmbajtje të përgjigjes së dërguar dhe dokumentacionit bashkëlidhur, lidhur me pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për blerjen e apartamentit. Në përgjigjen e saj, shoqëria¹⁰ ka konfirmuar sërish se pagesat janë kryer nga vetë z. **, në llogarinë bankare të shoqërisë.

20.3 Me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2021, Banka *** ka informuar Komisionin se, nga transaksionet e pasqyruara në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., gjatë periudhës **.1.2012 - **.12.2013, është evidentuar veprimi me referencë: **, datë **.12.2012, me përshkrim: “**** **** **** *derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21.500 euro – komisioni 0.03%) në vlerën 21,493.55 euro*”.

20.4 Referuar lëvizjeve në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.¹¹, pranë *** Bank, rezulton se, gjatë periudhës **.7.2012 - **.12.2012, janë kryer disa depozitime *cash* në këtë llogari, në total në shumën 82.566 euro, me përshkrim: “****.*** *likuidim këst apartamenti *****”.

⁷ Referohuni shkresës të shoqërisë me nr. *** prot., datë **.6.2021.

⁸ Me anë të kësaj shkrese, shoqëria informon se, me dorëzimin e dokumentacionit pranë hipotekës, numërtimi i apartamentit ka ndryshuar, nga nr. *** në nr. **, dhe me nr. ** është përgatitur dhe nënshkruar kontrata e shitjes.

⁹ Referuar dokumentacionit bankar të përcjellë me shkresën e shoqërisë “****” sh.p.k., nr. *** prot., datë **.6.2021, rezulton se në llogarinë bankare të kësaj shoqërie pranë *** Bank, gjatë periudhës **.7.2012 - **.12.2012, janë kryer disa depozitime *cash*, që në total janë në shumën 82.566 euro, dhe secili, si përshkrim veprimi, kanë emrin e bashkëshortit të subjektit.

¹⁰ Referohuni shkresës së shoqërisë me nr. *** prot., datë **.7.2021.

¹¹ Referohuni nxjerrjes së llogarisë bankare të *** Bank, bashkëlidhur shkresës së shoqërisë “****” sh.p.k., nr. *** prot., datë **.6.2021.

20.5 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me pagesat e kryera në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., në përgjigje të pyetësorit datë 20.9.2021, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Të vetmet pagesa që janë bërë nga bashkëshorti, janë ato të kryera cash në dy këste. Një pagesë është bërë në datë **.7.2012 (mandate arkëtimi nr. **, datë **.7.2012, me vlerë 97.000 euro ... pagesa tjetër apo kësti i fundit ... është kryer në datë **.7.2012. ...Për sa i përket konstatimit tuaj se në llogarinë e shoqërisë *** shpk, në ***, në monedhën euro, është evidentuar veprimi me referencë ***, datë **.12.2012, i cili në përshkrim të tij ka të cilësuar: “***.*** derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21.500 euro – komisioni 0,03 %, në vlerën 21.493,55 euro”, ju sqaroj se është kërkuar në *** Bank praktika lidhur me veprimin me referencë ***, datë **.12.2012 ...Pasi u njoha me këto dokumente, si unë dhe bashkëshorti im, konstatoam se shkrimi emër mbiemër ***.***, si dhe nënshkrimi, nuk ishin shkrimi dhe nënshkrimi i bashkëshortit tim. Të ndodhur në këto kushte, duke qenë se dokumentet ishin të falsifikuara, bashkëshorti i ka kërkuar një ekspert privat që të kryejë një akt ekspertimi grafik [...].*

20.6 Lidhur me pagesat e kryera në llogarinë e shoqërisë, pranë *** Bank, subjekti ka depozituar shkresën e kësaj banke me nr. *** prot., datë **.10.2021. Me anë të kësaj shkrese, banka konfirmon derdhjet që janë kryer në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “***.*** likuidim këst apartamenti ***” dhe bashkëlidhur ka vënë në dispozicion mandatet bankare përkatëse¹². Ashtu sikurse konfirmon edhe banka, rezulton se këto transaksione nuk janë nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, çka bie ndesh me përgjigjen e shoqërisë, e cila informon Komisionin se pagesat janë kryer nga vetë z. ***, në llogarinë bankare të shoqërisë.

20.7 Në përgjigje të pyetjeve të dërguara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar edhe shkresën kthim përgjigje të shoqërisë “****” sh.p.k., datë **.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, ku, nga përmbajtja e saj, konstatohet se shoqëria, ndryshe nga sa ka deklaruar më parë për Komisionin, informon subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, se vlera e arkëtuar në shumën 97.000 euro, me mandat arkëtimi nr. **, datë **.7.2012, është depozituar në bankë pjesë-pjesë, në ditë të ndryshme, nga një përfaqësues i shoqërisë. Në përshkrimin e depozitimit janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e blerë nga personi i lidhur.

20.8 Si pjesë të përmbajtjes së kësaj shkrese, shoqëria në fjalë ka paraqitur edhe ekstrakt të kartelës së klientit, ku konstatohen pagesat e kryera në llogaritë bankare në *** Bank dhe ***, por në ndryshim nga përgjigjet e dërguara më parë Komisionit, përcakton se mandatpagesa e datës **.12.2012, në shumën 21.493,55 euro, raportohet si depozitim në bankë nga ekonomisti i shoqërisë “****” sh.p.k.

21. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka kryer analizën financiare për periudhën gusht-dhjetor 2012, lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, për kryerjen e pagesës në shumën 21.493,55 euro, në datën **.12.2012, pranë

¹² Mandati, datë **.7.2012, në shumën 7.000 euro, me përshkrimin: “***.***, këst hipoteke apartament ***”, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. ***.*** Si dhe mandatet, datë **.10.2012; dt. **.11.2012; dt. **.11.2012; dt. **.11.2012; dt. **.11.2012; dt. **.12.2012 dhe datë **.12.2012, me përshkrimin: “***.*** këst apartamenti ***”, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. ***.***.

¹³, dhe pasi ka konstatuar se: (i) *Duket se shuma prej 21.493,55 euro, depozituar në datën **12.2012, në bankën ***, është paguar personalisht nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit;* (ii) *Subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e pagesës në shumën 21.493,55 euro;* (iii) *Shuma prej 104.000 euro është paguar cash nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në arkën e shoqërisë “” sh.p.k., bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.*

21.1 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ, ku ka deklaruar se të vetmet pagesa janë ato të kryera cash, nga bashkëshorti, në vitin 2012. Ndërsa lidhur me pagesën e konstatuar në ***, ndër të tjera, deklaroi se: *[...] Depozitimi i shumës 21.493,55 euro është kryer në degën e ***-së në Tiranë, e cila vuri në dispozicion kopje të dokumentit ...Pavarësisht të dhënave të sipërcituara, Komisioni, duke argumentuar se akti i ekspertimit është kryer mbi fotokopje, nuk e ka pranuar shpjegimin e bashkëshortit dhe ka vlerësuar gabimisht se shuma 21,493.55 euro është paguar prej tij... Depozitimi i shumës në bankë, sipas praktikës së bankës, rezultoi të jetë kryer në orën 09:44, ndërkohë që bashkëshorti në orën 09:00 - 09:10 ka qenë në një gjyq në Gjykatën e Rrethit Shkodër, më pas në orën 10:30 ka qenë në një gjyq tjetër dhe në orën 13:00 deri në 13:25 ka qenë në një gjyq tjetër, përsëri në Gjykatën e Rrethit Shkodër. Në këto kushte, bashkëshorti e ka pasur të pamundur të ishte njëkohësisht edhe në Shkodër, duke kryer me intensitet punën e tij (atë ditë ka qenë i pranishëm në tri seanca gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Shkodër, seanca të zhvilluara në orën 09:00, në orën 10:30 dhe në orën 13:00, si dhe ka marrë 3 vendime përfundimtare, përveç detyrave të tjera), edhe në Tiranë, që të kryente veprime në ***...Gjithashtu bëj me dije Komisionin se kam paraqitur edhe një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan, për veprën penale të “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” [...].*

21.2 Në përfundim, Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të kundërtën e barrës së provës, ndër të tjera, ka vlerësuar se¹⁴: *[...] bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar cash vlerën e apartamentit në shumën 104.000 euro, e cila më pas është arkëtuar pjesë-pjesë nga shoqëria “***” sh.p.k., në llogaritë e saj bankare në *** dhe *** Bank, për rrjedhojë, shuma 21.493,55 euro nuk përbën një shumë të paguar mbi vlerën e apartamentit. Në përfundim të kësaj analize, Komisioni vendosi që në analizën financiare të vitit 2012 të mos përfshijë shumën 21.493,55 euro, përtej vlerës prej 104.000 eurosh, të paguar për apartamentin....është provuar që: (i) nuk është bashkëshorti që ka kryer depozitimin e shumës 21.493,55 euro; (ii) shoqëria “***” sh.p.k. ka konfirmuar se kjo shumë është depozituar nga ekonomisti i saj për të plotësuar vlerën 104.000 euro, të paguar cash nga bashkëshorti; (iii) çmimi i paguar për apartamentin justifikon sipërfaqen e tij, si dhe (iv) subjekti nuk ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare [...].*

22. Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, për pasurinë apartament me sip. 87.3 m² dhe verandë me sipërfaqe 73.5 m², vlerëson se përfundimi i arritur

¹³ Referohuni aktit “Relacion mbi aktet e hetimit, datë **.3.2022”, f. 12-13.

¹⁴ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në f. 16-17, të vendimit.

nga Komisioni nuk është plotësisht i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me pagesën e kryer pranë ***-së, në shumën 21.493,55 euro.

22.1 Në vlerësimin e rrethanave të rastit, Komisioni i jep vëmendje provave me burim nga shoqëria “****” sh.p.k., ndërkohë që nga tërësia e akteve të administruara nga kjo shoqëri, gjatë hetimit administrativ, rezultojnë përgjigje kontradiktore, si me mënyrën e pagesës së çmimit, periodicitetin e pagesave dhe subjektet që i realizojnë ato.

22.2 Kështu, referuar kontratës së shitblerjes datë **.7.2012, palët bien dakord se vlera e apartamentit prej 104.000 euro është likuiduar totalisht. Porse, gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të shkresave të dërguara nga ana e Komisionit, shoqëria, fillimisht, konfirmon se pagesat janë kryer në llogarinë bankare të shoqërisë, nga bashkëshorti i subjektit, edhe pas korrikut të vitit 2012, ndërsa në përgjigjen drejtuar subjektit të rivlerësimit, e cila është më pas në kohë nga përgjigjet drejtuar Komisionit, informon se vlera e arkëtuar *cash* nga bashkëshorti i subjektit, në korrik 2012, është depozituar në bankë pjesë-pjesë nga përfaqësues të shoqërisë, deri në fund të vitit 2012, përfshirë dhe pagesën e kryer pranë ***-së, në shumën 21.493,55 euro, në emër të personit të lidhur.

22.3 Komisioneri Publik, sa më sipër, vëren se, pavarësisht se subjekti deklaron se çmimi i blerjes së apartamentit është likuiduar *cash* në korrik të vitit 2012, mbetet i paqartë shkaku dhe qëllimi i depozitimit dhe i pranimit nga ana e shoqërisë ndërtuese, i pagesës së shumës 21.493,55 euro, kryer në ***, në dhjetor 2012, pagesë kjo e identifikuar nga akti bankar si pagesë e kryer nga bashkëshorti i subjektit, me qëllim blerjen e apartamentit.

22.4 Në të tilla rrethana juridike kontradiktore, të paraqitura nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., në lidhje me elemente të rëndësishme të kësaj marrëdhënie kontraktuale lidhur mes shoqërisë, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, e që kanë të bëjnë me momentin e pagesës së çmimit, si dhe subjektit që kryen pagesat, elemente që ndryshe deklarohen në korrespondencën e shoqërisë me Komisionin dhe ndryshe në aktet e hartuara për llogari të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik vlerëson se është i nevojshëm një hetim i mëtejshëm nga ana e Kolegjit, që do të lejonte administrimin në cilësinë e provës përpara gjykatës, nën përgjegjësinë ligjore përkatëse, të të gjitha veprimeve të kryera nga ana e shoqërisë në lidhje me apartamentin të deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

III.B. Për kontrollin e figurës

23. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, në referencë të nevojës së kryerjes së një hetimi të plotë dhe verifikimit të ekzistencës eventuale të të gjitha kushteve të parashikuara nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, mangësitë në hetimin e Komisionit, edhe në drejtim të administrimit të plotë të informacioneve nga të gjitha organet ndihmëse për kriterin e figurës, sikurse parashikon Kreu V i këtij ligji, për sa kohë rezulton të mos jetë administruar informacioni i SHISH-it, do të duhet të riparohen gjatë gjykimit të këtij ankimi në Kolegji.

IV. Kërkimi i ankimit

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

25. Bazuar në kërkesat e nenit Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 524, datë 8.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA